



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 1918 Prot

Vlorë, më 22.08 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2026

“PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR AKSESIN NË OBJEKTIN E PROPOZUAR NGA AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT NDODHUR NË ZK 3140, PASURIA ME NR. 363, ME SIPËRFAQE 137.5 M2, NDODHUR NË RADHIMË VLORE”

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neneve 261 - 292 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja “c”, nenit 54 shkronja “e/1” të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Nenit 34 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”; Vendim nr. 234, datë 17.4.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 600, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësive ndërmjet enteve pronare të rrugëve, Shkresën nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit me nr. 2958/4 prot. datë 29.06.2026 drejtuar Bashkisë Vlorë, Urdhërin e Brendshëm nr. 1233, datë 14.08.2026, “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës nr. 2958 prot datë 29.06.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për konfirmimin e aksesit në objektin e propozuar”, shkresës nr. 17082 prot. datë 21.08.2026 drejtuar Njësisë Administrative Orikum:

VENDOSI:

- 1.Dhënie e dakortësisë për aksesin në objektin e propozuar nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit ndodhur në ZK 3140, pasuria me nr. 363, vol. 4, faqe 125, për sipërfaqen 137.5 m2, ndodhur në Radhimë Vlorë.
- 2.Ngarkohen Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Urbanistikës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Konceptoi: A. Pleyi

Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve:
B. Bisholla

Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

Drejtoria e Urbanistikës:

I.Xhaferaj

Drejtoria Juftike:

M.Mishgjoni

KRYETAR
Brunilda Mersini

ME URDHËR DELEGIMI
NËNKRYETAR
Edmond Beqiri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 13108 Prot

Vlorë, më 22.08 2026

R E L A C I O N

“PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR AKSESIN NË OBJEKTIN E PROPOZUAR NGA AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT NDODHUR NË ZK 3140, PASURIA ME NR. 363, RADHIMË VLORE”

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neneve 261 - 292 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja “c”, nenit 54 shkronja “e/1” të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Nenit 34 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”; Vendim nr. 234, datë 17.4.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 600, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve”, Shkresën nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit me nr. 2958/4 prot. datë 29.06.2026 drejtuar Bashkisë Vlorë, Urdhërin e Brendshëm nr. 1233, datë 14.08.2026, “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës nr. 2958/4 prot datë 29.06.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për konfirmimin e aksesit në objektin e propozuar”, shkresës nr. 17082 prot. datë 21.08.2026 drejtuar Njesisë Administrative Oriku:

Objekti i këtij relacioni është dhënia e dakordësisë për aksesin në objektin e propozuar nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit ndodhur në zk 3140, pasuria me nr. 363, Radhimë Vlorë, marrë shkak nga shkresa me nr. 2958/4 prot, datë 29.06.2026 nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, me lëndë: “Kërkesë për informacion”, me objekt Leje Ndërtimi për ndërtimin e objektit “ Objekt rezidencial dhe hotelier 3,4,5,6 dhe 7 kate, me 2kate nëntokë dhe pishinë, me vendndodhje në Radhimë Vlorë”, me zhvillues shoqërinë “GIGA Konstruksion” sh.p.k.

Pasuria me nr.363 e llojit “rrugë+kanal”, e ndodhur në zonën kadastrale 3140, me sipërfaqe 1500 m2, është në inventarin paraprak të Njesisë Administrative Oriku referuar edhe shkresës me nr. 1300/1 prot datë 26.08.2026 të Njesisë Administrative Oriku, ku bashkëlidhur është edhe fleta e inventarit paraprak.

Me qëllim trajtimin e kërkesës së AZHT , gjithashtu u ngrit dhe urdhëri i brendshëm me nr.1233, datë 14.08.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës nr. 2958, datë 29.06.2026, të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për konfirmim të aksesit në objektin e propozuar”, si dhe u mbajt dhe akt-konstatimi me nr.16682/1prot, datë 21.09.2026 nga ku u evidentua në terren se midis pasurive me nr.211/4 /, 211/3, 211/2, dhe pasurive me nr.209/6, 209/5, 209/4, në hartën treguese të regjistrimit

(HTR) pasqyrohet kanali me numër pasurie 363. Pjesa takuese e kësaj pasurie që kufizohet me pasuritë e sipërpërmendura duke u matur grafikisht në rilevimin topografik është me përmasa 5.5 m2 x 25 m2, në total 137.5 m2 nga sipërfaqja totale prej 1500 m2 ku figuron gjurma e kanalit.

Si rezultat i punimeve të kryera nga ndërtimi i rrugës, gjurma e këtij kanali nuk duket dhe nuk është i dallueshëm, pasi ka bimësi të ndryshme të cilat e pengojnë shikueshmërinë e kanalit,

(Bashkëlidhur foto të konstatimit në terren).Grupi i punës ka hartuar edhe planrilevimin për pozicionimin e pasurisë .

Në bazë të nenit 34, pika 2.1 e Ligjit nr. Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar ku citohet se:

2.1Për pronat shtetërore apo publike, të cilat figurojnë në përgjegjësi administrimi të institucioneve publike, servituti i kalimit jepet nga KKTU-ja së bashku me lejen e zhvillimit apo të ndërtimit, pas marrjes së dakordësisë nga institucioni përkatës.

Duke shprehur dakortësinë, ky akses mund të revokohet në të gjitha rastet nëse Shoqëria “GIGA Konstruksion“:

1. Pengon infrastrukturën e kullimit duke prishur parametrat e kalimit kullues si pjerësia, prerja tërthore dhe funksionaliteti i tij.

2. Nëse kjo pasuri bëhet pjesë e një projekti publik.

3. Nëse bëhet pjesë e konfliktit me palë të treta.

4. Nëse nuk krijon akses për pastrimin e këtij kanali, me pika kontrolli

Bashkëlidhur relacionit janë bashkëlidhur dokumentacionet e vendosura në dispozicion nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, grupi i punës, Njësia Administrative Orikum.

1- Shkresa me nr. 564/7 prot, datë 01.07.2026 nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit

2-Urdhërin e Brendshëm nr. 1280, datë 24.08.2026, “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës nr. 564/7 prot datë 01.07.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për konfirmimin e aksesit në objektin e propozuar”.

3-Akt konstatimi me nr. 16682/1 datë 21.09.2026

4- Shkresa nr. 1300/1 prot. Datë 26.08.2026 kthim përgjigje Njësia Administrative Orikum.

5- Shkresë nr. 17082 prot. Datë 21.08.2026 drejtuar Njesisë Administrative Orikum.

6- Shkresa nr. 16910/1 prot. Drejtuar NSHP, Sektorit të Bordit të Kullimit.

7- Kthim përgjigje e Sektorit të Bordit të Kullimit nr. 930/1 prot. Datë 21.09.2026.

Për sa më lartë vendimmarrja juaj për këtë vendim, merret sipas Neni 54, pika e/1 të Ligjit Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ju faleminderit!

Konceptoi: A. Plepi

Grupi punës: Aiken Hoxha

Bardhyl Shytaj

Seldi Dalipaj

DREJTOR

Bruna Bisholla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 16682/prot

Vlorë, më 21.08.2026

AKT -KONSTATIMI

I mbajtur sot më datë 08.09.2026, në Radhimë Vlorë, ZK 3140 në zbatim të Urdhërit të Brendshëm Nr.1233, datë 14.08.2026, të Kryetares së Bashkisë Vlorë, “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës Nr.2958 /4 Prot, datë 29.06.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit “Për konfirmim të aksesit në objektin e propozuar ”Objekt Rezidencial dhe Hotelier me 3,4,5,6, dhe 7 kate , me 2 kate nëntokë dhe pishinë, me vendndodhje , Radhimë Vlorë.”

Ky urdhër është ngritur bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “, neni 8 , Neni 9.1, pika 1.1/”a” dhe “ b” , Neni 23, pika 9 , Neni 64 pika “a” dhe “gj” , Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.31, datë 29.04.2025 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave te paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, Qarku Vlorë”, Udhëzimin Nr.1 datë 06.05.2016 , Udhëzimin Nr.24, datë 07.12.2016, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Ligjin Nr. 107/2014 “ Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, si dhe kërkesën Nr. 2958/4 Prot, datë 29.06.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, drejtuar Bashkisë Vlorë.

Në zbatim të këtij Urdhëri dhe kërkesës së përsëritur të AZHT-së , grupi i punës më datë 08.09.2026 ka kryer verifikimin në terren në pasurinë objekt i këtij urdhëri dhe është konstatuar se në Zonën Kadastrale Nr. 3140, fshati Radhimë ndodhet kanali me Nr. 363 Pasurie, i cili pasqyrohet në hartën treguese të regjistrimit (HTR).

Sipërfaqja që do të përdoret nga “Shoqëria GIGA Konstruksion” është 137.5 m2, (gjerësi 5.5 m dhe gjatësi 25 m) , sipas planimetrisë së lejes së ndërtimit miratuar nga AZHT-ja ku është e përcaktuar me shigjetë të zezë, segmenti që kërkohet akses në sheshin e ndërtimit.

Gjithashtu u konstatua se si rezultat i punimeve të kryera nga ndërtimi i rrugës , gjurma e këtij kanali nuk duket dhe nuk është e dallueshme, pasi ka bimësi të ndryshme të cilat e pengojnë shikueshmërinë e kanalit.(bashklidhur foto të konstatimit në terren)

Për sa më sipër grupi i punës, ka hartuar plan rilevimi për pozicionimin e pasurisë me Nr.363, të llojit kanal ku për sipërfaqen prej 137.5 m2 do të jepet pëlqimi për akses sipas hartës topografike në shkallën 1: 500 që shoqëron shkresën e AZHT- së .

GRUPI I PUNËS

Seldi Dalipaj



Bardhyl Shytaj





Aiken Hoxha











SUBJEKTI "GIGA KONSTRUKSION" SH.P.K.

 SIPËRFAQE E KANALIT NR.PASURIE 363 = 137.5 M²

 RRUGA RADHIMË - ORIKUM BYPASS DYTËSOR

SIPËRFAQE TOTALE = 137.5 M²



HARTA KADASTRALE SHKALLA 1:1000



ORTOFOTO SHKALLA 1:1000

13072
30 06 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ZHVILLIMIT NË TERRITOR

Nr. 2958/14 Prot.

Tiranë, më 29.06.2026

Lënda: Rikërkesë për informacion

BASHKISË VLORE

Në vijim të komunikimit të mbajtur me Ju në lidhje me aplikimin me Nr. AN091020250019, protokolluar pranë AZHT me Nr. 6211 Prot., datë 09.10.2025, për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: **"Objekt rezidencial dhe hotelier 3, 4, 5, 6 dhe 7 kate, me 2 kate nëntokë dhe pishinë, me vendodhje në Radhimë, Bashkia Vlorë"**, me zhvillues shoqërinë "GIGA Konstruktion" sh.p.k., si dhe shkresës tuaj me Nr. 7575/3 Prot, datë 21.05.2026 protokolluar pranë AZHT-së me Nr.2958/3 Prot, datë 25.05.2026, lutemi që:

Në përputhje me VKM-në 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Urdhrin Nr. 143, datë 03.11.2015 të Kryeministrit "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse për bashkërendimin e punës me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT)", për përmbushjen e detyrimeve të përbashkëta ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional, të marrim vlerësimin Tuaj për këtë projekt-propozim si dhe aksesin në pronë konform infrastrukturës rrugore, sipas planit të vendosjes të dorëzuar nga subjekti zhvillues.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, ngelemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Adelajda ROKA



PLANI PËR OBJEKTIN: "OBJEKT REZIDENCIAL DHE HOTELIER ME 3,4,5,6 DHE 7 KATE MBITOKË DHE 2 KATE NËNTOKË,ME PISHINË, ME
JE NË RADHIMË,BASHKIA VLORË, ME SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË "GIGA KONSTRUKSION" SH.P.K




PLANI I VENDOSJES SË STRUKTURËS SHK. 1: 250



POZICIONI KADASTRAL SHK. 1:1000



HARTA TOPOGRAFIKE SHK. 1:1000



PAMJE TREDIMENSIONALE

TREGUESIT E ZHVILLIMIT:	
Sipërfaqja e përgjithshme e truallit:	2777.5 m ²
Sipërfaqja e truallit e zënë nga struktura (gjurmja):	695 m ²
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërimit mbi tokë me ballkone:	5141.5 m ²
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërimit mbi tokë pa ballkone:	5085.5 m ²
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërimit nën tokë:	3785 m ²
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërimit mbi dhe nën tokë:	8870.5 m ²
Sipërfaqja pishine:	84 m ²
Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për ndërimit:	25%
Intensiteti i ndërimit:	1.83
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kështjës së sistemit:	26.52 m
Numri i kateve mbi tokë:	3,4,5,6,7 kat
Numri i kateve nën tokë:	2 kat
TREGUESI TEKNIK:	
Nr. pasurie: 209/11, 209/12, 209/13, 209/14, 209/15, 211/9, 211/10, 211/11, 211/12, 211/13	
Zona kadastrale nr. 3140	
Kufizimet:	
Distanca nga kufiri i pronës:	
Vendi:	3.9 m për objektin 3,5,7 kate nga kufiri i pronës
Jug:	4.3 m për objektin 4,6 kate nga kufiri i pronës
Lindje:	16.7 m për objektin 1 kat nga kufiri i pronës
Pendim:	16.3 m për objektin 2 kate nga kufiri i pronës
	17.1 m për objektin 4 kate nga kufiri i pronës
	17.5 m për objektin 5 kate nga kufiri i pronës
	5.8 m - 8 m për objektin 6 kate nga kufiri i pronës
	6 m për objektin 7 kate nga kufiri i pronës
Distanca nga trupi i rrugës:	
Vendi:	15.7 m - 17.8 m për volumnin 7 kate nga trupi i rrugës
Jug:	12.9 m - 17 m për volumnin 6 kate nga trupi i rrugës
Lindje:	13.9 m për volumnin 3 kate nga trupi i rrugës
Pendim:	
Distanca nga objektet rrethuese:	
Vendi:	21.1 m për volumnin 7 kate nga objekti ekzistues 3 kate
Jug:	10 m për volumnin 7 kate nga objekti 7 kate
LEGJENDE:	
Kufi i Pronës	Shtrirja Pllaka
Rruga	Gjelbërim
Kufi Kati Pendje	Hyrje
Kontur Objekt i Ri	Objekt i Ri
Kontur Nëntoka	Shtrirja Pllaka Tërheq

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT
DHE UJIT

MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T.U

Z. EDI RAMA

Z. Blendi Gonxhja

Ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Miratuar me Vendim të KKTU Nr.38, Datë 17/10/2025

LEJE NDËRTIMI PËR OBJEKTIN: "Objekt rezidencial dhe hotelier me 3,4,5,6 dhe 7 kate mbitokë dhe 2 kate nëntokë, me pishinë, me vendodhje në Radhimë, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Giga Konstruksion" sh.p.k

EMËRTIMI I FLETËS:	Plani i vendosjes së strukturës "Objekt rezidencial dhe hotelier me 3,4,5,6 dhe 7 kate mbitokë dhe 2 kate nëntokë, me pishinë, me vendodhje në Radhimë, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Giga Konstruksion" sh.p.k
PROJEKTUES:	SON Engineering & Construction
ZHVILLUES:	GIGA Konstruksion
FAZA E PROJEKTIT:	PROJEKT ZBATIMI
SHKALLA 1: 250	NR. I FLETES A-01
	NR. I KOPIJEVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KRYETARI

Nr. 16682 prot.

Vlorë, më 14.08 2026

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 1233 datë 14.08 2026

“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR TRAJTIMIN E KËRKESËS NR. 2958 PROT. DATË 29.06.2026 TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR KONFIRMIM TË AKSESIT NË OBJEKTIN E PROPOZUAR”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, Neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, Neni 23, pika 9, Neni 64 pika a dhe gj, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.31, datë 29.04.2025 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, të Qarkut Vlorë”; në Udhëzimin nr.1 datë 06.05.2016 dhe Udhëzimin nr.24 datë 07.12.2016) “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe në Ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, si dhe në kërkesën nr. 2958/4 prot. datë 29.06.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, drejtuar Bashkisë Vlorë.

URDHËROJ:

1. Të ngrihet grupi i punës për verifikimin në terren të pasurisë nr. 363, ndodhur në ZK 3140, vol. 4, F 125, ndodhur në Vlorë, i përbërë nga anëtarët si më poshtë:

- Bardhyl Shytaj, Topograf DPPMA

- Aiken Hoxha, Topograf DPPMA ✓

- Seldi Dalipaj, Jurist DPPMA

2. Grupi i punës sipas pikës 1, duhet të verifikojë në terren pasurinë e llojit rrugë – kanal në pronësi “shtet”, të mbaj akt konstatimi, të pasqyrojë në plan rievimi situatën faktike të

pronës, si dhe të përcaktojë sipërfaqen në m2 që do të përdoret për aksesin në objektin e propozuar nga AZHT.

4. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen personat sipas pikës 1 të Urdhërit, si dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

KRYETAR

Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E URBANISTIKËS

Nr. 13092/1 prot.

Vlorë, më 1307 2026

Lënda: Përcjellje të shkresës me Nr.13092 Prot. datë 30.06.2026.

DREJTORISË SË PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Në vijim të shkresës me Nr.2958/4 Prot. datë 29.06.2026, administruar pranë Bashkisë Vlorë me Nr.13092 Prot., datë 30.06.2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit ku kërkon vlerësimin për projekt propozimin e aksesit për në pronë , sipas plan vendosjes së dorëzuar nga subjekti zhvillues “ GIGA Konstruksion” sh.p.k për objektin : “ Objekt rezidencial dhe hotelier 3, 4, 5, 6 dhe 7 kate , me 2 kate nëntokë dhe pishinë , me vendndodhje në Radhimë, Bashkia Vlorë, po ju përcjellim shkresën e sipërcituar për shqyrtimin dhe trajtimin e mëtejshëm nga ana juaj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR

Ingli Xhaferaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE ✓

Nr. 16 P/10 / prot.

Vlorë, më 16.09 2026

Lënda: Mbi informacionin për kanalin kullues .

**NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORIT TË BORDIT TË KULLIMIT**

Në bazë të urdhërit të brendshëm të punës nr. 1233 datë 14,08,2026 prot.16682 “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e kërkesës nr . 2958 prot .datë 29,06,2026 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për konfirmim të aksesit në objektin e propozuar” .

Kërkojmë nga ana juaj të na informoni nëse kanalet kullues me nr.363 pasurie dhe nr . 252 pasurie Zk .3140 të ndodhura në Radhimë janë pjesë e sistemit kullues të administruar / mirëmbajtur nga ana juaj dhe nëse janë funksional.

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju vendosim në dispozicion shkresat e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

Duke ju falënderuar!

DREJTOR

Bruna Bisholla



16910/2
22.03.2026

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE

NDERMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. 930/1 Prot

Vlorë, më 21.09.2026

Lënda: Informacion për kanalet kulluese.

**DREJTORISË SË PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETVE
BASHKIA VLORE**

Në përgjigje së suajës nr.16910/1 Prot., date 16.09.2026 hyrë në institucion nr.930 Prot., date 21.09.2026, ku kërkon informacion nëse kanalet kulluese me Nr. 363 Pasurie dhe Nr. 252 Pasurie Zk 3141 të ndodhura në Radhimë ku janë pjesë e sistemit kullues të administruar mirëmbajtur nga ana jonë dhe nëse janë funksional, ju sqarojmë si më poshtë:

Sipas VKM-së Nr. 1108 datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit", ka transferuar gjithë asetet e tij pranë Bordit të Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Vlorë.

Bashkitë bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën për planifikimi e nevojave për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit.

Kanalet kulluese të ndodhura në Zk 3140 në Radhimë me Nr.363 Pasurie dhe Nr.252 Pasurie janë pjesë e inventarit paraprak të Njesisë Administrative Orikum, Bashkia Vlorë.

Nga sa më sipër kanalet me Nr.363 Pasurie dhe Nr.252 Pasurie, të ndodhura në Radhimë janë pjesë e mirëmbajtjes nga Sektori I Bordit të Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Vlorë.

DREJTOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM

Nr. 1300/2 prot.

Vlorë, më 26.08 2026

Lënda: Përgjigje kërkesë për informacion

Drejtoria Pronave Publike Menaxhimit të Aseteve
Bashkia Vlore

Në vijimësi Suajës të datës 21.08.2026, me nr.17082prot., protokolluar pranë Njesisë Administrative Orikum më datën 24.08.2026, me nr.1300prot., ku kërkon konfirmim që prona e llojit kanal, me numër pasurie 363 e ndodhur në zonën kadastrale 3140, me sipërfaqe 1500 m², nëse është në inventarin paraprak të Njesisë Administrative Orikum, ju shprehemi si më poshtë:

Pasuria me nr.363 e ndodhur në ZK.3140 me sipërfaqe 1500 m², e llojit kanal është në inventarin paraprak të Njesisë Administrative Orikum.

ADMINISTRATOR

Drini Haradinaj





3	4	5	6	7	8	9	10	11
0	359	Kanal	Kanal Fshati Radhime Bashkia Orikum	Fshati Radhime Bashkia Orikum	3800	M.B.U.M.K.	D.B.U. Vlore	
0	360	Kanal	Kanal Fshati Radhime Bashkia Orikum	Fshati Radhime Bashkia Orikum	5300	M.B.U.M.K.	D.B.U. Vlore	
0	361	Kanal	Kanal Fshati Radhime Bashkia Orikum	Fshati Radhime Bashkia Orikum	4000	M.B.U.M.K.	D.B.U. Vlore	
0	362	Kanal	Kanal Fshati Radhime Bashkia Orikum	Fshati Radhime Bashkia Orikum	12500	M.B.U.M.K.	D.B.U. Vlore	
0	363	Kanal	Kanal Fshati Radhime Bashkia Orikum	Fshati Radhime Bashkia Orikum	1500	M.B.U.M.K.	D.B.U. Vlore	
0	364	Kanal	Kanal Fshati Radhime Bashkia Orikum	Fshati Radhime Bashkia Orikum	11400	M.B.U.M.K.	D.B.U. Vlore	
0	365	Kanal	Kanal Fshati Radhime Bashkia Orikum	Fshati Radhime Bashkia Orikum	200	M.B.U.M.K.	D.B.U. Vlore	
0	366	Kanal	Kanal Fshati Radhime Bashkia Orikum	Fshati Radhime Bashkia Orikum	7800	M.B.U.M.K.	D.B.U. Vlore	

